



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:045935

Datë: 27.06.2024

Numri i dokumentit: 05866259

Ac.nr.421/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: B.B nga fshati C....., Komuna e D....., Gj.L nga fshati C....., Komuna e D..... të cilën e përfaqëson M.B, avokate nga Komuna e Deçanit, A.L nga fshati C....., Komuna e D....., E.L nga fshati C....., Komuna e D....., B.Gj.A nga fshati S....., Komuna e D....., T.B nga fshati C....., Komuna e D....., A.V nga fshati S....., Komuna e D....., A.D–Q nga fshati C....., Komuna e D....., të cilët me autorizim i përfaqëson F.K, avokat nga Komuna e Pejës, kundër të paditurës Komuna e Deçanit –Drejtoria e Arsimit në Deçan, për kompensimin e shujtës-shpenzimeve të ushqimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan, C.nr.240/20, të datës 04.09.2020, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 19.06.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Deçanit –Drejtoria e Arsimit në Deçan, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan, C.nr.240/20, të datës 04.09.2020, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.240/20, të datës 04.09.2020, ka vendosur si vijon: “ *I. APROVOHET NE TERESI, padia dhe kërkesa e paditësve B.B nga fsh. C....., Komuna e D....., Gj.L nga fsh. C..... K-D..... të cilën e përfaqëson Av. M.B nga Komuna Deçan, dhe paditësit: A.L nga fsh. C.....K-D....., E.L nga fsh. C..... K-D....., B.Gj–A nga fsh. S.....K-D....., T.B nga fsh. C..... K-D....., A.V nga fsh. S.....K-D....., A.D–Q nga fsh. C..... K-D....., të cilët me autorizim i përfaqëson Av. F.K nga Komuna Pejë,*

*DETYROHET, e paditura Drejtoria e Arsimit në Deçan që paditësve t'ia paguaj shumat e kompensimit të ushqimeve ditore (Shujta) dhe atë:*

*Për paditësen B. B nga fshati C.....K-D..... shumën prej 1,000 € (një mijë€)*

*Për paditësen Gj.L nga fsh. C.....K-D..... shumën prej 1,000 € (një mijë€)*

*Për paditësin A.L nga fsh. C.....K-D.....shumën prej 1,000 € (një mijë€)*

*Për paditësin E.L nga fsh. C..... K-D..... shumën prej 812 € (tetëqind e dymbëdhjetë€)*

*Për paditësen B.Gj-A nga fsh. S.....shumën prej 644 € (gjashtë qind e katërbëdhjetë€ )*

*Për paditësen T.B nga fsh. C.....shumën prej 1,000 € (një mijë€)*

*Për paditësen A.V nga fsh. S.....K-D..... shumën prej 1,000 € (një mijë€)*

*Për paditësen A.D –Q nga fsh. C.....K-D.....shumën prej 1,000 € (një mijë€)*

*OBLIGOHET, e paditura Komuna Deçanit –Drejtoria e Arsimit ti paguaj shpenzimet procedurale në emer të përfaqësimit për Av. M.B dhe atë për paditëset si vijon : B.B , Gj.L. për përpilimin e (2) padive 208 (dyqind e tetë)€ , për taks 42 (katerdhjetë e dy)€, për një seancë 202.80 (dyqind e dy€ e tetëdhjetë cent ) gjithsejtë 452 (katërqind e pesëdhjetë e dy€) , gjitha këto në numrin e gjiro llogarisë : ..... në Bankën Ekonomike në emer të Av. M.B K-D..... .Ndërsa për Av. F. K në emer përfaqësimit t'ia paguaj shumat si vijon : për përpilimin e padive të A.L nga fsh. C.....i Epërm K-D....., E.L nga fsh. C..... K-D....., B.Gj –A. nga fsh. S..... K-D....., T.B nga fsh. C.....K-D....., A.V nga fsh. S..... K-D.....,A.D –Q nga fsh. C..... K-D....., për (6) padie ne vlerë prej 104 (njëqind e katër€) gjithsejtë 624 (gjashtëqind e njëzetë katër€), për taks (6x21) gjithsejtë 126 (njëqind e njëzete e gjashtë)€, për një seancë 470 (katërqind e shtatëdhjetë€ ) gjithsejtë 1.220 (njëmijë e dyqind e njëzetë€), të gjitha këto në ne numër gjiro llogarisë : .....në Bankën Ekonomike.E të gjitha këto me kamat ligjore prej 8% pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive në kërcenim përmbarrim me dhunë”.*

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor, ka paraqitur ankesë e paditura, përmes të autorizuarit të saj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës të aprovojë ankesën dhe të anulojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështjen ta kthejë në rivendosje dhe rishqyrtim ose që të vendose në mënyrë meritore.

Përgjigje në ankesë kanë paraqitur të autorizuarit e paditësve duke e kundërshtuar në tërësi ankesën e të paditurës me propozim që e njëjtë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit përmes të autorizuarve të tyre, kanë ushtruar padi në gjykatën e shkallës së parë me datën 17.04.2020 kundër të paditurës për

kompensimin e shujtave ditore, ku për paditësen A.D-Q ta detyroj të paditurën që t'ia paguaj për 529 ditë shumën 1,058€, për paditësen T.B për ditët e punës 529 ditë shumën 1,058€, për paditësen A.V për 507 ditë shumën 1,014€, për paditësen E.L për 406 ditë shumën 812€, për paditësen B.Gj.A për 322 ditë shumën 644€, për paditësin A.L për 529 ditë shumën 1,058€, të gjitha këto me kamatë 8 % nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit të ankimuar si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë në mënyrë zyrtare ka bërë bashkimin e lëndëve me numra C.nr 240/20 me dt. 05.08.2020 ku ka bashkuar lëndët me numër C.nr 244/20, C.nr 275/20, C.nr 277/20, C.nr 279/20, C.nr 280/20, C.nr 283/20, C.nr 286/20 dhe lënda ka marr numrin C.nr. 240/20, për shkak të parimit ekonomizimit sepse baza juridike është e njëjtë dhe se të gjithë janë nga e njëjta shkollë Fillore "Lidhja e Prizrenit" nga Komuna e Deçanit.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.240/20 të datës 04.09.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk ishte kontestuese se paditësit janë mësimdhënës, përkatësisht Sekretar i Shkollës të Mesme të Ulët "L....." në C..... Komuna e D.....t dhe atë që nga data 05.02.2016. Për gjykatën nuk ishte kontestuese zbatimi i Kontratës Kolektive nga Drejtoria e Arsimit ndaj paditësit për ushqimin ditor të cilën e paditura nuk e kishte përmbushur, andaj gjykata duke u mbështetur në kontratën e nënshkruar në mesë paditësve dhe paditurës e cila parashihet se paditësit në bazë të kontratës ka obligim orë pune deri 40 orë në javë dhe e paditura ti paguaj shujtat ditore për ushqim. E paditura duke mos e kryer detyrimin e saj, rezulton se i ka mbetur borxh paditësve për pagesën ushqimit ditor përkatesisht shujta, andaj ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit. Kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe përmes provave për paditësen B.B, Kontrata e Punës me numër protokollit 37083/07 dt. 04.12.2018, vërtetimi mbi orarin e punës me numër protokollit 03-4911-20, vërtetimi për përvojën e punës 4804/03 dt. 20.02.2020. Për paditësen Gj.L, kontrata e punës me numër protokollit 26554/07, vërtetimi mbi orarin e punës me numër protokollit 03-4912/20 dt. 02.09.2020, për paditësin A.L, kontrata e punës me numër protokollit 33999/07 dt.08.11.2017, vërtetimi mbi orarin e punës me numër protokollit 03/4916/20 dt. 02.09.2020, për paditësen B.Gj, kontrata e punës me numër protokollit 38655/07 dt. 26.12.2018, vërtetimi mbi orarin e punës me numër protokollit 03/4918/20 dt. 02.09.2020, për paditësin E.L, kontrata e punës me numër protokollit 13673/02 dt. 11.05.2018, vërtetimi mbi orarin e punës me numër protokollit 03/4917/20 dt. 02.09.2020, për paditësen A.V, kontrata e punës me numër protokollit 28462-07 dt. 06.09.2018, vërtetimi mbi orarin e punës me numër protokollit 03/4915/20 dt. 02.09.2020, për paditësen T.B, kontrata e punës me numër protokollit 26633-07 dt. 02.12.2014, vërtetimi mbi orarin e punës me numër protokollit 03/4914/20 dt. 02.09.2020, për paditësen A.D-

Q, kontrata e punës me numër protokollit 26621-07 dt. 03.12.2014, vërtetimi mbi orarin e punës me numër protokollit 03/4913/20 dt. 02.09.2020. Lidhur me pretendimin për parashkrimin e kërkesës nga pala e paditur gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës ka gjetur se padia e paditësve është paraqitur me datë 17.04.2020, dhe nga dispozita e lartcekur rrjedh se kërkesa e paditësve nuk është parashkruar sepse kemi të bëjmë me marrëdhënie detyrimi në mes paditëses dhe të paditurës dhe se afati i përgjithshëm i parashkrimit është pesë vite, andaj gjykata e aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

Lidhur me mënyrën e vendosjes vendimin e bazoi në nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, për kamatën ka vendosur konform nenit 382 të LMD-së dhe vendimi për shpenzimet e procedurës kontestimore është bazuar në nenin 452.1 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), n) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së (nga referati i ankesës kuptohet. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se përmes provave për paditësen B.B, Kontrata e Punës me numër protokollit 37083/07 dt. 04.12.2018, vërtetimi mbi orarin e punës me numër protokollit 03-4911-20, vërtetimi për përvojën e punës 4804/03 dt. 20.02.2020. Për paditësen Gj.L, kontrata e punës me numër protokollit 26554/07, vërtetimi mbi orarin e punës me numër protokollit 03-4912/20 dt. 02.09.2020, për paditësin A.L, kontrata e punës me numër protokollit 33999/07 dt.08.11.2017, vërtetimi mbi orarin e punës me numër protokollit 03/4916/20 dt. 02.09.2020, për paditësen B.Gj, kontrata e punës me numër protokollit 38655/07 dt. 26.12.2018, vërtetimi mbi orarin e punës me numër protokollit 03/4918/20 dt. 02.09.2020, për paditësin E.L, kontrata e punës me numër protokollit 13673/02 dt. 11.05.2018, vërtetimi mbi orarin e punës me numër protokollit 03/4917/20 dt. 02.09.2020, për paditësen A.V, kontrata e punës me numër protokollit 28462-07 dt. 06.09.2018, vërtetimi mbi orarin e punës me numër protokollit 03/4915/20 dt. 02.09.2020, për paditësen T.B, kontrata e punës me numër protokollit 26633-07 dt. 02.12.2014,

vërtetimi mbi orarin e punës me numër protokoll 03/4914/20 dt. 02.09.2020, për paditësen A.D-Q, kontrata e punës me numër protokoll 26621-07 dt. 03.12.2014, vërtetimi mbi orarin e punës me numër protokoll 03/4913/20 dt. 02.09.2020, për të kryer detyrat si në kontrata e cila nuk ishte kontestuese nga palët. Nga vërtetimet e lëshuara vërtetohet fakti se paditësit A.D-Q ka 529 ditë pune të pranishme, për paditësen T.B ka 529 ditë pune të pranishme, për paditësen A.V ka 507 ditë pune të pranishme, për paditësin E.L ka 406 ditë pune të pranishme, për paditësen B.Gj-A ka 322 ditë pune të pranishme, për paditësin A.L ka 529 ditë pune të pranishme. Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë dhe duke bazuar në ligj e ka zbatuar të drejtën materiale, duke u bazuar në nenin 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar, në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale për arsye se:

Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*.

Me nenin 35 paragrafin 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe e datës 22.01.2021, përcaktohet se: *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy)€ për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditëses, duke vendosur decidivisht si në dispozitivin e aktgjyqimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e lindjes së të drejtës për parashtrim të kërkesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, që nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadsisë së paditësit.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko - civil, ndaj paditësve për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit – shujtës gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e*

*detyrimin ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.*

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, duke e obliguar të paditurën që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për paditësen A.D-Q ka detyruar të paditurën që t’ia paguaj për 529 ditë shumën 1,058€, për paditësen T.B për ditët e punës 529 ditë shumën 1,058€, për paditësen A.V për 507 ditë shumën 1,014€, për paditësen E.L për 406 ditë shumën 812€, për paditësen B.Gj-A për 322 ditë shumën 644€, për paditësin A.L për 529 ditë shumën 1,058€, me të drejtë është bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës ( MASHT), e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e parashtrimit të kërkesës për kompensimin shpenzimeve të ushqimit për ditët në punë, që rrjedhimisht nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadisë.

Në raport me pretendimin ankimor të të paditurës se e njëjta nuk ka mundur të planifikojë në skemën e saj buxhetore, linjë të veçantë për këtë lloj kompensimi, është i pabazuar, ngase një pretendim i tillë nuk e argumenton mos pagesën e pagave jubilarë dhe shujtës ditore, një e drejtë që i takon paditëses.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452.1 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palës ankuese, por të cilat nuk patën relevancë në vendosje ndryshe, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.421/2021, me datë 19.06.2024

Kryetare e kolegjit,  
Nora Bllaca-Dula, d.v

Numri i lëndës: 2020:045935  
Datë: 27.06.2024  
Numri i dokumentit: 05866259